



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1127/11 prot

Datë 08.06.2026

V E N D I M

Nr. 766/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro
Anila Malaj
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Anëtar
Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 619/2026, datë 11.05.2026 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-79574-03-18-2026, me objekt: “*Shpenzime për mirëmbajtjen e qarqeve të ndriçuesve Led*”, me fond limit 3,332,100 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Fredy Electronic” SHPK me NIPT (K91803020F) me adresë: Rruga e Kavajës, Pallati 207, Shk.2, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, me adresë: Rruga “5 Maji”, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 11.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.619/2026, ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-79574-03-18-2026, me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e qarqeve të ndriçuesve Led”, me fond limit 3,332,100 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Fred Electronic” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar atë.*
3. *Autoriteti kontraktor të bëjë rivlerësim të procedurës së prokurimit në SPE, në zbatim të konstatimeve të KPP-së në këtë vendim.*
4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera*
5. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.2112 prot., datë 18.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1127/8 prot., datë 25.05.2026, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 619/2026, datë 11.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.2112 prot., datë 18.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1127/8 prot., datë 25.05.2026, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 619/2026, datë 11.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 619/2026, datë 11.05.2026 të KPP-së. Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 619/2026, datë 11.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me arsyetimet e konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-79574-03-18-2026, me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e qarqeve të ndriçuesve Led”, me fond limit 3,332,100 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

